



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 tetor 2016
Nr. ref.:AGJ978/16

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI65/15

Parashtrues

**Tatjana Davila
Ljubiša Marić
Zorica Kršenković
Zlatoj Jevtić**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të 3 (tri) aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme, përkatësisht aktgjykimeve nr. GSK-KPA-A-021/12, të 17 janarit 2013, GSK-KPA-A-141/12, të 17 prillit 2013 dhe GSK-KPA-A-045/12, të 3 tetorit 2012, dhe 2 (dy) vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, përkatësisht KPCC/D/A/211/2013, të 21 gushtit 2013 dhe KPCC/D/C/216/2013, të 22 nëntorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga 4 (katër) parashtrues: (i) parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila, me banim në Auckland, Zelanda e Re; (ii) parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić, me banim në Vrnjačka Banja, Serbi; (iii) parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković, me banim në Beograd, Serbi; dhe (iv) parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić, me banim në Beograd, Serbi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë mospërmbarimin e 5 (pesë) vendimeve të ndryshme, përkatësisht 2 (dy) vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KKPK) dhe 3 (tri) aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Apelit të AKP-së).
 - Parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila e konteston mospërmbarimin e aktgjykimeve të Kolegjit të Apelit të AKP-së nr. GSK-KPA-A-021/12, të 17 janarit 2013 dhe GSK-KPA-A-141/12, të 17 prillit 2013.
 - Parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić e konteston mospërmbarimin e Vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/A/211/2013, të 21 gushtit 2013.
 - Parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković e konteston mospërmbarimin e Vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/C/216/2013, të 22 nëntorit 2013.
 - Parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić e konteston mospërmbarimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së nr. GSK-KPA-A-045/12, të 3 tetorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimeve të lartcekura të KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive), nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit), nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
4. Objekti i çështjes ka të bëjë me vendime të ndryshme të KKPK-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së, por kërkesa në thelb është e njëjtë në lidhje me të katër parashtruesit e kërkesës, pasi që të gjithë ata pretendojnë mospërmbarimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe u referohen dispozitave të njëjta të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.
5. Pretendimi i përbashkët i të katër parashtruesve të kërkesës është shkelja e pritjeve të tyre legjitime për përmbarimin e vendimeve të formës së prerë dhe të detyrueshme të KKPK-së si dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së në favor të tyre.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 28 maj 2015, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
8. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
9. Më 19 shkurt 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës, Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) dhe Kolegjin e Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 14 shtator 2016, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe të konstatojë shkelje.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me parashtruesen e kërkesës Tatjana Davila

11. Më 2 tetor 1984, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila, në bazë të trashëgimisë, ishte bërë bashkëpronare, së bashku me vëllanë e saj, të një numri të pronave në territorin e komunës së Prishtinës, zonën e Veternikut. Këto prona janë të regjistruara në fletën poseduese nr. 6633, Zona Kadastrale Prishtinë dhe të specifikuara si ngastra kadastrale nr. 1818/2, ngastra kadastrale nr. 1819/2 dhe ngastra kadastrale nr. 4940/2.
12. Më 19 gusht 1994, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila, në bazë të një kontrate të dhuratës, u bë bashkëpronare, së bashku me vëllanë e saj, e një tjetër prone që gjendet në territorin e komunës së Prishtinës, zonës së Veternikut, të regjistruar në fletën poseduese nr. 6633 Zona Kadastrale Prishtinë, ngastra kadastrale nr. 1814/2.
13. Edhe pse parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila nuk banon më në Kosovë, ajo gëzoi posedimin e bashkëpronësisë së pronave të lartcekura deri më 12 qershor 1999, kur vëllai i saj u largua nga territori i Kosovës menjëherë pas përfundimit të luftës. Pronat më pas u uzurpuan nga një palë e tretë.
14. Më 4 korrik 2006, gjatë një vizite në Kosovë, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila parashtrroi padi në AKP për konfirmimin e të drejtës së posedimit mbi pronat në fjalë.

15. Më 7 shtator 2011, KKPK-ja, me Vendimin KPCC/D/A/121/2011, ia njohu të drejtën e e posedimit parashtrueses së kërkesës, në mënyrë më specifike, bashkëpronësinë e saj mbi pronat e përmendura më lart. Pasi që parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila tani ishte me banim në Auckland, Zelandë të Re, vendimet i ishin dërguar fillimisht parashtrueses së kërkesës me email, në fund të vitit 2011. Më pas, parashtrueses së kërkesës vendimet i janë dorëzuar fizikisht më 29 gusht 2012.
16. Në pjesën relevante të vendimit të lartcekur të KKPK-së theksohet: *“Në kërkesat nr. 11399, 11400 dhe 11401 parashtruesja e kërkesës (Tatjana Davila) parashtrroi kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore, pikërisht si bashkëpronarë. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se u largua nga Kosova në vitin 1995 për t'u vendosur në Zelandën e Re ku atje banon ende edhe sot. Vëllai i saj, i cili është bashkëpronar e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në vitin 1999 kur ai u largua si pasojë e konfliktit. Parashtruesja e kërkesës dorëzoi disa dokumente ne mbështetje të kërkesës së saj, përfshirë vendimin e trashëgimisë së 2 tetorit 1994, kontratën e dhurimit të 19 gushtit 1994 dhe certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të 30 tetorit 2007. Këto dokumente tregojnë se parashtruesi i kërkesës është bartës i së drejtës pronësore dhe të gjitha janë të verifikuara si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive”.*
17. Me Vendimin e KKPK-së, gjithashtu, përcaktohet se parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila ka dëshmuar të drejtën e saj të pronësisë mbi pronën e pretenduar dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palës së paditur, të gjitha pretendimet e saj ka gjasa të aprovohen.
18. Ndërkohë, 4 (katër) palë të tjera, palë të treta që nuk ishin përfshirë më parë në këtë rast, e kontestuan vendimin e KKPK-së në Kolegjin e Apelit të AKP-së, dhe kërkuan njohjen e të drejtave të tyre të posedimit mbi parcela të caktuara të pronave të njëjta.
19. Më 15 dhjetor 2011, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë kërkoi nga AKP-ja që t'i përfshijë këto prona në të ashtuquajturën “Skemën e Qirasë të AKP-së”, e cila përfshin administrimin e pronave nga ana e AKP-së, dhe mbledhjen e të ardhurave nga qiraja në emër të bartësit të të drejtave pronësore.
20. Më 17 janar 2013, Kolegji i Apelit të AKP-së nxori Aktgjykimin GSK-KPA-A-021/12, me të cilin ankesa e një prej palëve të treta, kundër Vendimit të KKPK-së KPCC/D/A/121/2011, në rastin e AKP-së nr. 11401, ngastra kadastrale nr. 4949/2, është refuzuar si e papranueshme, dhe është vërtetuar vendimi i kontestuar i KKPK-së.
21. Të njëjtën ditë, Kolegji i Apelit i AKP-së nxori Aktgjykimin GSK-KPA-A-141/12, me të cilin ankesat e 3 (tri) palëve të treta kundër Vendimit të KKPK-së KPCC/D/A/121/2011, në lidhje me parcelat në rastin e AKP-së nr. 11400 (ngastra kadastrale nr. 1818/2 dhe ngastra kadastrale nr. 1819/2) dhe rasti i AKP-së nr. 11399 (ngastra kadastrale nr. 1814/2), ishin refuzuar si të pabazuara dhe ishte vërtetuar vendimi i kontestuar i KKPK-së.

22. Më 3 korrik 2013, parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila i ishin dorëzuar aktgjykimet e lartpërmendura të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
23. Pas aktgjykimeve të lartcekura të Kolegjit të Apelit të AKP-së, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila ishte informuar se gjatë administrimit të pronave nga ana e AKP-së, kishte ndryshuar statusi i pronave të regjistruara në fletën poseduese nr. 6633, Zona Kadastrale Prishtinë, për shkak se në to ishin ndërtuar shtëpitë, në mënyrë të paautorizuar dhe të paligjshme.
24. Më 8 shtator 2014, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila parashtroi padi për kthim të pronës, pasi ajo pretendoi se AKP-ja nuk i kishte respektuar obligimet që ajo i kishte ndërmarrë.
25. Në një datë të pacaktuar, AKP-ja propozoi procedurë të ndërmjetësimit për parashtruesen Tatjana Davila, për të gjetur një zgjidhje paqësore për zgjidhjen e çështjes së përdorimit të pronës.
26. Më 19 shkurt 2015, AKP-ja caktoi një ndërmjetësues në kontestin ndërmjet parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila dhe palëve të treta.
27. Më 16 mars 2015, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila dorëzoi një parashtrësë në AKP për tërheqje nga procedura e ndërmjetësimit pasi që konsideroi se janë përmbushur arsyet e justifikueshme dhe objektive për tërheqjen e saj. Përveç kësaj, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurës, ajo i propozoi AKP-së që të ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme brenda afatit sa më të shkurtër kohor për përmbarimin e vendimeve të KKP-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së, në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, përkatësisht, për t'i mundësuar asaj kthimin e pronave të saj dhe ta kthejë atë në pozitën e saj fillestare, duke i hequr objektet e ndërtuara në mënyrë të paligjshme.
28. Më 17 mars 2015, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila dërgoi një të ashtuquajtur "letër urgjence" për AKP-në, duke kërkuar informata urgjente në lidhje me statusin e rastit të saj, sepse ajo nuk kishte marrë asnjë njoftim nga AKP-ja për masat e ndërmarra.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me parashtruesin e kërkesës Ljubiša Marić

29. Parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić, në bazë të trashëgimisë, kishte fituar pronësinë mbi disa prona që gjenden në komunën e Obiliqit, Zona Kadastrale Millosheve, dhe e regjistruar në fletën poseduese nr. 176, përkatësisht parcelat kadastrale: nr. 176, nr. 648, nr. 301/1, nr. 304/1, nr. 657, nr. 658, nr. 303/1, nr. 305/1 dhe nr. 305/3.
30. Parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić ka gëzuar posedimin e pronave të lartcekura deri më 12 qershor 1999, kur u largua nga Kosova. Pronat më pas u uzurpuan nga një palë e tretë.

31. Në një datë të pacaktuar në vitin 2006, pas kthimit në Kosovë, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić parashtroi kërkesë në AKP për konfirmimin e të drejtave të tij të posedimit mbi pronat e lartpërmendura.

32. Më 21 gusht 2013, KKPK-ja me vendimin KPCC/D/A/211/2013 konstatoi, *inter alia*, se:

“a) Parashtrues (it) i(e) kërkesës (ave) sipas detajeve më lart ka/kanë dëshmuar se Ljubiša Marić është pronar i pronës së kërkuar;

b) Ljubiša Marić ka të drejtë në posedimin e pronës në fjalë;

c) I padituri, nëse ka ndonjë, dhe çdo person tjetër, i cili e shfrytëzon pronën, duhet ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe

d) Nëse i padituri, apo çdo person tjetër, i cili e shfrytëzon pronën dështon të përmbush urdhrin për të liruar pronën e kërkuar brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona”.

33. Në arsyetimin e vendimit të lartcekur të KKPK-së theksohet:

“Në bazë të provave në dispozicion dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga i padituri, [KKPK] konsideron se kërkesa duhet të miratohet. Kërkesat numër 23637, 23638, 23639, 23640, 23641, 23642, 23643, 23644, 23646 dhe 23647 janë paraqitur nga [parashtruesi i kërkesës] në cilësinë e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. [Parashtruesi i kërkesës] kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe rikthimin e posedimit mbi pronën në fjalë. Në mbështetje të kërkesës së tij, [parashtruesi i kërkesës] paraqiti fletën poseduese të vitit 2006, e cila e tregon [parashtruesi i kërkesës] si pronarin e pronës së kërkuar. Kjo fletë poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive [e AKP-së] si e vërtetë. I padituri kërkon të drejtën ligjore mbi pronën në fjalë, duke pretenduar se pronën e kërkuar e kishte blerë nga [parashtruesi i kërkesës]. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, [i padituri] paraqiti kontratën e shitblerjes së vitit 2006, të lidhur në mes të paditurit si blerës dhe [parashtruesit të kërkesës] përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, juristit Bedri Çitaku, si shitës të pronës në fjalë. Sekretaria Ekzekutive ka kontaktuar më vonë me [parashtruesin e kërkesës] për ta ballafaquar me pretendimet e të paditurit. [Parashtruesi i kërkesës] deklaroi se ai nuk ia ka shitur pronën e kërkuar të paditurit. Për më tepër, ai deklaroi se autorizimi [i avokatit Bedri Çitakut] i dorëzuar nga i padituri është i falsifikuar. Sekretaria Ekzekutive kërkoi nga Agjencia Kosovare për Forenzikë që të shqyrtojë këtë autorizim. Në raportin e saj, Agjencia Kosovare për Forenzikë konkludoi se është e mundshme që nënshkrimet në autorizimin dhe në dokumentin e nënshkruar nga [parashtruesi i kërkesës] nuk janë nënshkruar nga i njëjti person. Sipas këtij raporti, autorizimi përmban disa karakteristika kryesore dhe individuale të cilat nuk përputhen me nënshkrimin e [parashtruesit të kërkesës]. Në këto rrethana, [KKPK-ja] konstaton se autorizimi në fjalë nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme se avokati Bedri Çitaku është

autorizuar në mënyrë të rregullt nga [parashtruesi i kërkesës] për ta shitur në emër të tij pronën e kërkuar dhe si i tillë transaksioni i pretenduar konsiderohet si i pavlefshëm. Nga kjo rrjedh se certifikata e azhurnuar për të drejtën mbi pronën e paluajtshme e cila e tregon të paditurin si pronarin e pronës së kërkuar është e gabuar dhe nuk mund të konsiderohet si provë për të drejtën pronësore të të paditurit. Rrjedhimisht, i padituri nuk ka ofruar mbrojtje të vlefshme ndaj kërkesës së [parashtruesit]. Në bazë të shqyrtimit të provave në dispozicion, dhe pasi që i padituri nuk kishte ofruar mbrojtje të vlefshme, [KKPK-ja] konkludon se kërkesa duhet të miratohet.”

34. Në janar të vitit 2014, Vendimi i KPKK-së i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Ljubiša Marić.
35. Më 20 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić kërkoi nga Kadastra e komunës së Obiliqit që t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në regjistrimin e pronësisë në bazë të vendimit të formës së prerë dhe detyrues të KPKK-së. Pretendohet se atij i ishte thënë se AKP-ja duhet të veprojë *ex officio* në mënyrë që kadastra të bëjë ndryshimet e nevojshme në regjistrimin e pronës.
36. Më 1 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić kërkoi nga AKP-ja që të largojë palën e tretë që kishte uzurpuar pronën e tij dhe që të bëjë ndryshimet e duhura në regjistrimin e pronës në Kadastrin e komunës së Obiliqit, në pajtim me vendimin e formës së prerë dhe detyrues të KPKK-së dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë.
37. Më 19 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić dërgoi një të ashtuquajtur "letër urgjence", duke kërkuar nga AKP-ja që urgjentisht ta informojë atë në lidhje me statusin e rastit të tij. Ai e përsëriti kërkesën në AKP që të veprojë *ex officio* në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, në mënyrë që të bëjë ndryshimet e duhura të regjistrimit të pronës në Kadastër të komunës së Obiliqit.
38. Më 19 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić përsëri parashtroi kërkesë për ndryshimin e regjistrimit të titullit të pronës në Kadastrën e Zonës së Obiliqit.
39. Deri në ditët e sotme, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić nuk ka marrë asnjë informatë nga AKP-ja në lidhje masat e ndërmarra për përmbarimin e vendimit të formës së prerë dhe detyrues të KPKK-së në favor të tij.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtrueses së tretë Zorica Kršenković

40. Më 10 shkurt 1992, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković kishte blerë një lokal afarist në Prishtinë në sheshin "Ulpiana", Lamela C, ndërtesa e programit YU, Zona Kadastrale Prishtinë.
41. Më 12 qershor 1999, ajo u largua nga Kosova. Pronat më pas u uzurpuan nga një palë e tretë.

42. Më 14 korrik 2006, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković parashtroi kërkesë në AKP për konfirmimin e të drejtave të saj të pronësisë mbi pronën e lartpërmendur.
43. Më 22 nëntor 2013, KKPK-ja nxori vendimin KPCC/D/C/216/2013, në rastin nr. KPA 13623, me të cilin konfirmoi se parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković ishte pronare legjitime e pronës.
44. Në vendimin e saj, KKPK-ja, *inter alia*, theksoi se:
- a) Parashtruesja (it) i(e) kërkesës (ave) sipas detajeve më lart ka/kanë dëshmuar se Zorica Kršenković është pronare e pronës së kërkuar;*
- b) Zorica Kršenković ka të drejtë në posedimin e pronës në fjalë;*
- c) I padituri, nëse ka ndonjë, dhe çdo person tjetër, i cili e shfrytëzon pronën, duhet ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri; dhe*
- d) Nëse i padituri, apo çdo person tjetër, i cili e shfrytëzon pronën dështon të përmbush urdhrin për të liruar pronën e kërkuar brenda kohës së dhënë, ata do të dëbohen nga prona”.*
45. Më 23 dhjetor 2013, parashtrueses së kërkesës Zorica Kršenković i ishte dorëzuar vendimi i KKPK-së.
46. Më 17 janar 2014, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković parashtroi kërkesë në AKP për kthimin e pronës.
47. Më 2 qershor 2014, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković dërgoi një të ashtuquajtur “letër urgjence” duke kërkuar nga AKP-ja që ta informojë për progresin e përmbartimit të rastit të saj.
48. Më 3 qershor 2014, në një bisedë telefonike, AKP-ja i dërgoi një garanci me gojë parashtrueses së kërkesës Zorica Kršenković se vendimi në fjalë do të përmbartohet në muajin në vijim.
49. Më 9 korrik 2014, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković ishte informuar me gojë se vendimi i KKPK-së do të përmbartohet brenda shtatë ditëve të ardhshme.
50. Më 24 korrik 2014, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković iu drejtua prapë AKP-së me një “urgjencë”.
51. Më 28 janar 2015, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković është njoftuar nga AKP-ja (Shkresa Ref. KPA 13623/CLA), se më 23 janar 2015, AKP-ja nxori vendim me të cilin vendimi i KKPK-së i 22 nëntorit 2013 në lidhje me kërkesën nr. KPA13623 ishte ndryshuar dhe ishte shpallur i pavlefshëm për shkak të “njoftimit të gabuar të pronës”. AKP-ja deklaroi se identifikimi i saktë i pronës do të përcaktohet dhe, më pas, do të lëshohet një njoftim i ri mbi pronën. Në letrën e AKP-së theksohet se parashtruesja e kërkesës do të informohet për

njoftimin e ri përkatës për këtë kërkesë pronësore. Pas lëshimit të njoftimit të ri për pronën, të gjitha palët e interesuara do të kenë mundësi që ta kontestojnë këtë njoftim. Deri sa të përfundohen të gjitha procedurat, nuk do të jetë i mundur përmbartimi i vendimit të KKKP-së.

52. Deri në ditët e sotme, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković nuk ka pranuar asnjë njoftim të ri ose konfirmim të rezultatit të rastit.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me kërkesën e parashtruesit të katërt Zlatoj Jevtić

53. Parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić, në bazë të trashëgimisë, është bashkë-pronar i një numri të pronave që gjenden në komunën e Prizrenit, dhe të regjistruara në fletën poseduese nr. 124, Zona Kadastrale Prizren Korishë, ngastra kadastrale nr. 2478/2, ngastra kadastrale nr. 2477/2 dhe ngastra kadastrale nr. 414 në vendin e quajtur "Gurina Kam" në Korishë.
54. Më 1 qershor 1999, ai u largua nga territori i Kosovës. Pronat më pas u pushtuan nga një palë e tretë.
55. Më 18 dhjetor 2006, parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić parashtoi kërkesë në AKP për konfirmimin e të drejtave të tij pronësore mbi pronën e lartpërmendur, e cila kishte qenë në posedim të tij deri më 1 qershor 1999.
56. Më 26 tetor 2011, KKKP-ja nxori vendimet e ndara vijuese për secilën prej ngastrave kadastrale: (a) KPCC/D/A/127/2011 për rastin nr. KPA 90737 (ngastra kadastrale nr. 2478/2) dhe KPA 14169 (ngastra kadastrale nr. 414); dhe (b) KPCC/D/R/130/2011, në rastin nr. KPA 14170 (ngastra kadastrale nr. 2477/2). Të gjitha këto vendime ishin në dobi të parashtruesit të kërkesës Zlatoj Jevtić, dhe me çdo vendim vërtetohej se parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić ishte pronar legjitim i ngastrës kadastrale përkatëse.
57. Më pas, një palë e tretë parashtoi ankesë kundër vendimeve të KKKP-së, duke kërkuar konfirmimin e të drejtave të posedimit të kësaj pale të tretë mbi pronat.
58. Më 3 tetor 2012, Kolegji i Apelit i AKP-së nxori Aktgjykimin Nr. GSK-KPA-A-45/12. Në atë aktgjykim, Kolegji i Ankesave i AKP-së e refuzoi ankesën e parashtruar nga pala e tretë si të pabazuar. Të gjitha vendimet e kontestuara të KKKP-së u vërtetuan.
59. Më 19 mars 2013, parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić parashtoi kërkesë për kthimin e posedimit të pronave në rastet e AKP-së - KPA 90737, KPA 14169 dhe KPA 14170.
60. Më 30 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić dërgoi një të ashtu-quajtur "urgjencë", duke kërkuar nga AKP-ja informata në lidhje me statusin e rastit të tij dhe duke insistuar që të përmbartohen vendimet e formës së prerë dhe të detyrueshme të Kolegjit të Apelit të AKP-së, me të cilat konfirmohen të drejtat e tij pronësore.

61. Parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić pretendon se, *“Deri në ditët e sotme [parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić] nuk ka pranuar ndonjë njoftim nga organet kompetente për rezultatin e kërkesës, si dhe njoftim të AKP-së për masat e ndërmarra me qëllim të ekzekutimit të vendimeve lidhur me rastin.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

62. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive), nenit 14 (Ndalimi i diskriminimit), dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e Pronës].
63. Pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës është se vendimet gjyqësore në rastet e tyre nuk janë përmbuar, dhe se procedurat kanë tejkaluar një kohë të arsyeshme, në shkelje të drejtës së tyre për gjykim të drejtë.
64. Sa i përket efektivitetit të mjeteve juridike, parashtruesit e kërkesës pohojnë se: *“Parashtruesit e kërkesës theksojnë faktin se në sistemin ekzistues juridik të Kosovës nuk ekziston mjet efektiv juridik, në bazë të të cilit do të ishte e mundshme që në rastet në fjalë të parandalohet shkelja e mëtejme e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (përveç duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës), dhe i cili do të ofronte kompensim të drejtë për zvarritje të pabazuar të procedurës së ekzekutimit të vendimeve të lartpërmendura”.*
65. Sa i përket kërkesës për përmbushje të afatit ligjor prej katër muajve siç parashihet me nenin 49 të Ligjit, parashtruesit e kërkesës pohojnë: *“Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës theksojnë se në procedurat e çështjes kushti për parashtrimin e një kërkeje brenda afatit prej katër muajve [...] nuk zbatohet në rast të mos-ekzekutimit të vendimeve të autoritetit publik”. Parashtruesit e kërkesës citojnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në mbështetje të këtij pretendimi.*
66. Përkitazi me përgjegjësinë juridike të AKP-së, parashtruesit e kërkesës theksojnë, *“se në bazë të kornizës ligjore në fuqi parashihet kompetenca ekskluzive e AKP në procedurat e ekzekutimit (zbatimit) të vendimeve të plotfuqishme dhe të detyrueshme të Gjykatës Supreme të Kosovës në rastet e AKP, duke përfshirë edhe vendimet e plotfuqishme të Komisionit. AKP-ja është e obliguar që të veprojë në pajtim me kompetencat e veta ligjore, duke shfrytëzuar mekanizmat ekzistues e posaçërisht duke vepruar në pajtim me Nenin 16.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 (miratuar me ligjin nr.03/L-079) i cili parasheh që nëse “gjatë zbatimit të urdhrit për dëbim, çdo person që nuk u përmbahet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për t’u larguar nga prona mund të largohet nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit”. Me mandatin e AKP-së me qëllim të përmbarimit të vendimeve parashihet edhe shkatërrimi i strukturave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme (Neni 15 i Ligjit nr. 03/L-079).”*

67. Sa i përket plotfuqishmërisë dhe përmbarueshmërisë së vendimeve të KKPK-së, parashtruesit e kërkesës pohojnë se, *“Në pajtim me nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, parashihet se: “Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.”*
68. Sa i përket plotfuqishmërisë dhe përmbarueshmërisë së vendimeve të Kolegjit të Apelit të AKP-së, parashtruesit e kërkesës pohojnë se, *“Neni 21.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 (të miratuar me Ligjin nr. 03/L-079), parashihet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës bëhet i plotfuqishëm në ditën kur iu dorëzohet palëve dhe është detyrues si aktgjykim i plotfuqishëm i Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me dispozitat e ligjit të aplikueshëm”.*
69. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se secili prej tyre kishin iniciuar procedurat për kthimin e pronave të tyre në vitin 2006, dhe se të gjitha këto procedura kanë përfunduar me vendimet e KKPK-së dhe të Komisionit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Deri më sot, asnjë nga këto vendime nuk janë përmbaruar nga AKP-ja. Për këtë arsye, është bërë një vonesë prej së paku 10 (dhjetë) vitesh nga fillimi i procedurave pa arritur një përfundim të procedurave.
70. Në rastin e parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila aktgjykimet përfundimtare të Kolegjit të Apelit të AKP-së ishin nxjerrë më 17 janar 2013.
71. Në rastin e parashtruesit të kërkesës Ljubiša Marić vendimi përfundimtar i KKPK-së ishte nxjerrë më 21 gusht 2013.
72. Në rastin e parashtrueses së kërkesës Zorica Kršenković vendimi përfundimtar i KKPK-së ishte nxjerrë më 22 nëntor 2013, megjithatë, baza për ekzekutim, përkatësisht “njoftimi i pronës”, është ende në pritje për ndryshime.
73. Në rastin e parashtruesit të kërkesës Zlatoj Jevtić, Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të AKP-së ishte nxjerrë më 3 tetor 2012.

Pranueshmëria e kërkesës

74. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesat e parashtruesve, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbyshur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
75. Sa i përket kërkesave të parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
76. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike, të parapara me ligj dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, ata iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me kërkesën

për përmbarimin e Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, përkatësisht Vendimit nr. HPCC/REC/91/2007, të 19 janarit 2007, dhe Vendimit nr. HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006.

77. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh se: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht”*.
78. Gjykata dëshiron të theksojë se kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit prej 4 (katër) muajve nuk vlen në rastin e mospërmbarimit të vendimeve nga autoriteti publik. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) thekson në mënyrë eksplicite se në një situatë të ngjashme, që paraqitet në rastin e *Iatridis kundër Greqisë*, rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendimin konkret (shih, *mutatis mutandis*, *Iatridis kundër Greqisë*, nr. 59493/00, GJEDNJ, Aktgjykimi i 19 tetorit 2000).
79. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”*.
80. Sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë treguar saktësisht se cilat të drejta, të garantuara me Kushtetutë pretendojnë se u janë shkelur me mospërmbarimin e vendimeve të KKPB-së në rastet e tyre.
81. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë në mënyrë legjitime të jenë viktimat të mospërmbarimit të vendimeve të KKPB-së.
82. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, se janë shteruar të gjitha mjetet juridike, se është përmbushur kushti i dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor si rezultat i situatës së vazhdueshme dhe se i kanë sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, si dhe i janë referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre për gëzimin dhe posedimin e pronës.
83. Pasi që parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret procedurale të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, Gjykata konsideron se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim merititor.

Meritat e kërkesës

84. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për një proces të rregullt], nenin

13 [E drejta për zgjidhje efektive], nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit], nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e pronës] të Konventës.

85. Në këto raste, Gjykata do të shqyrtojë meritat e kërkesës në pajtim me nenin 31 në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 54 të Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Sa i përket shkeljes së pretenduar për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

86. Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesës kryesisht pretendojnë se zvarritja dhe mospërmbarimi i vendimeve të KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së, në kërkesat e tyre përkatëse pronësore shkel të drejtat e tyre për gjykim të drejtë.

87. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

88. Përveç kësaj, neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së parasheh:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

89. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

90. Gjykata rikujton praktikën e saj, siç theksohet në rastin KI144/14 & KI156/14 sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 të Republikës së Kosovës, Gjykata konstaton se AKP-ja është organ i vetëm kompetent për përmbarimin e vendimeve të KKPK-së dhe vendimeve të Kolegjit të Apelit të AKP-së. Ky fakt është konfirmuar edhe nga përfaqësuesit e AKP-së, të cilët morën pjesë si palë në dëgjimin publik, të mbajtur më 10 mars 2014, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastin nr. KI187/13.

91. Sa i përket të gjithë parashtruesve të kërkesës, Gjykata vëren se vendimet përfundimtare dhe të detyrueshme të KKPK-së, përkatësisht Kolegjit të Apelit të AKP-së, janë nxjerrë ndërmjet tetorit 2012 dhe nëntorit 2013.
92. Në rastin e parashtrueses së kërkesës Zorica Kršenković, Gjykata vëren se megjithëse vendimi përfundimtar i KKPK-ja është nxjerrë më 22 nëntor 2013, më 23 janar 2015, AKP-ja pohoi se baza për përmbarrim, përkatësisht "njoftimi i pronës", është ende në pritje për ndryshime.
93. Duke kërkuar përmbarrimin e këtyre vendimeve, secili prej parashtruesve të kërkesës i janë drejtuar disa herë me shkrim AKP-së, me kërkesë për përmbarrimin e vendimeve në rastet e tyre. Parashtruesit e kërkesës janë përpjekur vazhdimisht të shihnin se vendimet e formës së prerë në rastet e tyre janë përmbarruar.
94. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës), parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 25 korrikut 2004, *Romashov kundër Ukrainës*, nr. 67534/01).
95. Gjykata konsideron se përmbarrimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 19 marsit 1997, *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, para. 40). Në rastin konkret, GJEDNJ konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk do të duhej të ishin privuar nga përfitimi i përmbarrimit të vendimit të formës së prerë, që ishte marrë në favor të tyre.
96. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se asnjë autoritet nuk mund të arsyetojë moszbatimin e vendimeve me qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të rastit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 25 korrikut 2002, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, Nr. 48553, paragrafi 72, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 24 korrikut 2003, *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, paragrafi 52).
97. Autoritetet kompetente e kanë për obligim që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të panevojshme (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 nëntorit 2008, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21839/03, *Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 22731/02).
98. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të përcaktojë se cila është mënyra më e përshtatshme që AKP-ja, në kuadër të kompetencave që ka, t'i gjejë mekanizmat efikas të përmbarrimit, në kuptim të përmbushjes së plotë të detyrimeve që përcaktohen me ligj dhe Kushtetutë. Megjithatë, çdo individ gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë

të drejte të garantuar me Kushtetutë ose me ligj (shih: nenin 54 të Kushtetutës).

99. Gjykata dëshiron të theksojë se në Aktgjykimin e saj të 16 prillit 2014, në rastin nr. KI187/13, tashmë është marrë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimeve të KKPb-së. Në atë Aktgjykim, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenit 54 të Kushtetutës, si dhe shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për gëzimin paqësor të pronës së tyre, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si pasojë e mospërmbarimit (shih Aktgjykimin e 16 prillit 2014, KI187/13 N. Jovanović, *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme, GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012, dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011*).
100. Prandaj, barra e mospërmbarimit dhe mosgjetyes së mekanizmave përkatës për përmbarimin e vendimeve përfundimtare të KKPb-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së në rastet e parashtruesve të kërkesës, bie vetëm mbi AKP-në. Mungesa e mekanizmave zbatues të këtij institucioni, në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë arsye për mohimin e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për gëzimin e pronës.
101. Prandaj, Gjykata është e mendimit se AKP-ja ka obligim që t'i përmbarojë vendimet e KKPb-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
102. Si përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i vendimeve përfundimtare dhe të detyrueshme të KKPb-së, respektivisht të Kolegjit të Apelit të AKP-së, përbëjnë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Shkelja e pretenduar e gjykimit të drejtë në rastin e parashtrueses Tatjana Davila

103. Sa i përket parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila, Gjykata vëren se me Aktgjykimet e Kolegjit të Apelit të AKP-së (GSK-KPA-A-021/12), të 17 janarit 2013 dhe (GSK-KPA-A-141/12), të 17 prillit 2013 ishte vërtetuar e drejta e saj e bashkëpronësisë dhe posedimit mbi pronën e kontestuar. Deri më sot, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila nuk ka qenë në gjendje që të përfitojë nga përmbarimi i këtyre vendimeve.
104. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila ishte pajtuar me AKP-në që kjo e fundit ta administrojë pronën e saj, dhe për më tepër, ishte pajtuar për një procedurë ndërmjetësimi të ndihmuar nga AKP-ja, por me asnjërën nga këto procedura nuk u realizua kërkesa e saj për kthim të posedimit të pronës e cila ligjërisht ishte njohur të jetë e saj me vendimet përfundimtare dhe të detyrueshme të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
105. Gjykata konstaton se nuk është as e kuptueshme dhe as e pranueshme që, përderisa prona e parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila ishte nën

administrimin e AKP-së, një palë e tretë kishte mundësi të ndërtonte tetë shtëpi në këtë pronë.

106. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se që nga janari përkatësisht prilli i vitit 2013, parashtruesja e kërkesës Tatjana Davila, pavarësisht nga përpjekjet e saj, nuk ka arritur ta rikthejë posedimin e pronës së saj.
107. Për këto arsye, Gjykata konstaton se dështimi i AKP-së për t'i përmbaaruar vendimet e plotfuqishme dhe detyruese të Kolegjit të Apelit të AKP-së në lidhje me të drejtat e pronësisë së parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila përbën shkelje të së drejtës së saj për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Shkelja e pretenduar e gjykimit të drejtë në rastin e parashtruesit Ljubiša Marić

108. Sa i përket parashtruesit të kërkesës Ljubiša Marić, Gjykata vëren se me Vendimin e KKPK-së nr. KPCC/D/A/211/2013, të 21 gushtit 2013, ishte vërtetuar e drejta e tij pronësore dhe rrjedhimisht ai kishte të gjitha të drejtat e fituara mbi këtë bazë. Vendimi i KKPK-së u bë i plotfuqishëm dhe detyrues edhe për shkak se nuk u kontestua nga asnjë palë e interesuar në afatin e paraparë ligjor. Deri më sot, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić nuk ka mundur të përfitojë nga përmbarimi i këtij vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues.
109. Gjykata vëren se, që nga viti 2014, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić parashtroi kërkesa të shumta në Zyrën Kadastrale të komunës së Obiliqit dhe të AKP-së për të zbatuar vendimin përfundimtar dhe detyrues të KKPK-së në favor të tij, dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme në regjistrimin e titullit të tij pronësor. Deri më sot, nuk janë bërë këto ndryshime në kadastrë.
110. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić kërkoi nga AKP-ja që të sigurojë largimin e palës së tretë e cila e kishte uzurpuar pronën, por, deri më sot, AKP-ja nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me kërkesën e parashtruesit.
111. Gjykata konsideron se pasiviteti i AKP-së në lidhje me kërkesat e parashtruesit për të larguar palët e treta nga prona e tij dhe për të siguruar ndryshimet e nevojshme në kadastrë e bën vendimin e plotfuqishëm dhe detyrues të KKPK-së, më tepër iluzor dhe teorik se sa praktik dhe efektiv.
112. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se që nga gushti i vitit 2013, parashtruesi i kërkesës Ljubiša Marić, pavarësisht nga përpjekjet e tij, nuk ka qenë në gjendje ta rikthejë pronën e tij, dhe as ta regjistrojë atë në emër të tij.
113. Për këto arsye, Gjykata konstaton se dështimi i AKP-së për ta përmbaaruar vendimin e plotfuqishëm dhe detyrues të KKKK-së në lidhje me të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës Ljubiša Marić përbën shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Shkelja e pretenduar e gjykimit të drejtë në rastin e parashtrueses Zorica Kršenković

114. Sa i përket parashtrueses së tretë Zorica Kršenković, Gjykata vëren se më 22 nëntor 2012, KKPK-ja nxori vendimin nr. KPCC/D/C/216/2013, me të cilin konfirmoi se parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković është pronare e ligjshme e pronës. Vendimi i KKPK-së mori formë të prerë edhe për shkak se ai nuk ishte kontestuar nga asnjë palë e interesuar, brenda afatit të paraparë ligjor. Deri më sot, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković nuk ka mundur të përfitojë nga zbatimi i këtij vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues.
115. Megjithatë, Gjykata vëren se më 28 janar 2015, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković ishte njoftuar nga AKP-ja (letra Ref. KPA 13623/CLA), se më 23 janar 2015, AKP-ja kishte marrë vendim me të cilin vendimi i KKPK-së së 22 nëntorit 2013, në lidhje me kërkesën nr. KPA 13623 është ndryshuar dhe është shpallur i pavlefshëm për shkak të *"njoftimit të gabuar të pronës"*. AKP-ja deklaroi se do të përcaktohej identifikimi i saktë i pronës dhe, më pas, do të lëshohet një njoftim i ri mbi pronën. Në shkresën e AKP-së theksohet se parashtruesja e kërkesës do të informohet për njoftimin e ri për këtë kërkesë pronësore. Pas lëshimit të njoftimit të ri për pronën, të gjitha palët e interesuara do të kenë mundësi që ta kontestojnë këtë njoftim. Deri sa të përfundojnë të gjitha procedurat, përmbarimi i vendimit të KKPK-së nuk do të jetë i mundur.
116. Gjykata vëren se në nëntor të vitit 2012, parashtruesja e tretë Zorica Kršenković ishte konfirmuar si pronare legjitime me vendim të KKPK-së. Në janar të vitit 2015, që është më shumë se dy vite më vonë, ajo u informua nga AKP-ja se për shkak të një gabimi teknik në njoftimin e pronës, ai vendim i KKPK-së ishte shpallur i pavlefshëm.
117. Gjykata konstaton se për një periudhë prej më shumë se dy vitesh, AKP-ja dështoi në përmbarimin e vendimit përfundimtar dhe detyrues të KKPK-së në rastin e parashtrueses Zorica Kršenković. Më pas, me sa duket për shkak të një gabimi teknik të bërë nga vet AKP-ja, ky vendim përfundimtar i KKPK-së ishte shpallur i pavlefshëm dhe njoftoi se do të pasojë një njoftim i ri. Deri më sot, nuk ka pasur asnjë njoftim të ri.
118. Pa marrë parasysh se çfarë mund të jetë natyra e këtij gabimi teknik, Gjykata vlerëson se me një gabim të tillë teknik nuk mund të anulohet vendimi përfundimtar dhe detyrues.
119. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se që nga nëntori i vitit 2012, parashtruesja e kërkesës Zorica Kršenković, pavarësisht nga përpjekjet e saj, nuk ka qenë në gjendje që ta rikthejë pronën e saj.
120. Për këto arsye, Gjykata konstaton se dështimi i AKP-së për ta përmbaruar vendimin e plotfuqishëm dhe detyrues të KKPK-së në lidhje me të drejtat pronësore të parashtrueses së kërkesës Zorica Kršenković përbën shkelje të së drejtës së saj për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Shkelja e pretenduar e gjykimit të drejtë në rastin e parashtruesit Zlatoj Jevtić

121. Sa i përket parashtruesit të katërt Zlatoj Jevtić, Gjkata vëren se Aktgjykimi (GSK-KPA-A-45/12) i Kolegjit të Apelit të AKP-së ishte nxjerrë më 3 tetor 2012, dhe se me këtë aktgjykim ishte njohur e drejta pronësore e parashtruesit të kërkesës. Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të AKP-së u bë përfundimtar dhe detyrues dhe nuk i nënshtrohet ankesave të mëtejshme. Deri më sot, parashtruesi Zlatoj Jevtić nuk ka qenë në gjendje që të përfitojë nga zbatimi i këtij vendimi të formës së prerë dhe detyrues.
122. Gjkata vëren se që nga marsi i vitit 2013, parashtruesi i kërkesës Zlatoj Jevtić kishte paraqitur kërkesa në AKP për përmbarimin e aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së dhe për kthimin e pronës së tij. Deri më sot, AKP-ja nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me kërkesën e parashtruesit.
123. Gjkata konsideron se mosaktiviteti i AKP-së në lidhje me kërkesat e parashtruesit për kthimin e pronës së tij e bën aktgjykimin përfundimtar dhe detyrues të Kolegjit të Apelit të AKP-së më tepër iluzor dhe teorik, se sa praktik dhe efektiv.
124. Në këtë drejtim, Gjkata vëren se që nga tetori i vitit 2012, parashtruesi Zlatoj Jevtić, pavarësisht nga përpjekjet e tij, nuk ka qenë në gjendje që ta kthejë pronën e tij.
125. Për këto arsye, Gjkata konstaton se dështimi i AKP-së për ta përmbaruar vendimin e plotfuqishëm dhe detyrues të Kolegjit të Apelit të AKP-së në lidhje me të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës Zlatoj Jevtić përbën shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, siç garantohej me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës

126. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ka pasur edhe shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
127. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës, *inter alia*, parasheh:
 - 1) *“E drejta e pronës është e garantuar.*
 - 2) *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
 - 3) *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona (...)*

[...]

128. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, parasheh:

„Çdo preson fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në

interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mësipërme, sidoqoftë, nuk do të cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligjet, të cilat i vlerëson si të nevojshme për kontrollin e përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave e kontributeve apo gjobave të tjera”.

129. Gjykata rikujton Aktgjykimin e saj të 23 prillit 2012, ku theksoi se pasi që vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore bëhen të formës së prerë dhe *res judicata*, “parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar të drejtën e posedimit të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së” (shih Nr. KI104/10, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit GZ 78/2010, të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, të 7 qershorit 2010).
130. Në rastet e parashtruesve të kërkesës, vendimet përkatëse të KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së u bënë të formës së prerë dhe detyruese më 17 janar 2013, përkatësisht më 21 gusht 2013, 22 nëntor 2013, dhe 3 tetor 2012.
131. Si e tillë, e drejta për posedimin e pronës në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së për secilin parashtrues të kërkesës kishte filluar në këto data përkatëse.
132. Gjykata vëren se nuk janë përmbaruar vendimet e KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së, si në vijim:
 - Për parashtruesen e kërkesës Tatjana Davila, aktgjykimet e Kolegjit të Apelit të AKP-së nr. GSK-KPA-A-021/12, të 17 janarit 2013 dhe GSK-KPA-A-141/12, të 17 prillit 2013;
 - Për parashtruesin e kërkesës Ljubiša Marić, vendimi i KKPK-së nr. KPCC/D/A/211/2013, i 21 gushtit 2013;
 - Për parashtruesen e kërkesës Zorica Kršenković, vendimi i KKPK-së nr. KPCC/D/C/216/2013, i 22 nëntorit 2013; dhe
 - Për parashtruesin e kërkesës Zlatoj Jevtić, Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të AKP-së nr. GSK-KPA-A-045/12, i 3 tetorit 2012.
133. Gjykata konstaton se si pasojë e mospërmbarimit të këtyre vendimeve, parashtruesve të kërkesës u është mohuar e drejta për gëzimin paqësor të pronave të tyre, në shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1, Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së.

PËRFUNDIM

134. Si përfundim, Gjykata konstaton se mospërmbarimi i vendimeve të KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së në rastet e parashtruesve të kërkesës përbën shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNJ-së.

135. Bazuar në këto vlerësime dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore të saj, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konstaton se Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore të Kosovës dhe Aktgjykimet e Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës të Gjykatës Supreme të Kosovës ishin bërë *res judicata*.
136. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se si rezultat i mospërmbarimit të vendimeve përfundimtare dhe detyruese, parashtruesit e kërkesës janë privuar pa të drejtë nga prona e tyre, për shkak të vonesës dhe mospërmbarimit të vendimeve. Në këtë mënyrë, është shkelur edhe e drejta e parashtruesve të kërkesës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e tyre, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
137. Në fund, Gjykata konsideron se nuk duhet të merret më tej me pretendimet për shkelje të neneve 24, 32 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 13 dhe 14 të KEDNJ-së, krahas kërkesës së parashtruesve për t'u dhënë kompensim monetar, sepse pretendimet dhe kërkesat e tilla janë konsumuar nga gjetjet e Gjykatës për shkelje të neneve 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.7 dhe 116.1 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 56 (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

Në rastin e parashtrueses së kërkesës Tatjana Davila:

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të vlerësohet nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, dhe 54 të Kushtetutës, dhe të neneve 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- V. TË KONSTATOJË se 2 (dy) Vendimet e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. GSK-KPA-A-021/12, të 17 janarit 2013, nr. GSK-KPA-A-141/12, të 17 prillit 2013 duhet të përmbahen nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);
- VI. TA URDHËROJË Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës të Gjykatës, ta njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDOS

Në rastin e parashtruesit të kërkesës Ljubiša Marić

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të vlerësohet nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, dhe 54 të Kushtetutës, dhe të neneve 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- V. TË KONSTATOJË se Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore i Kosovës nr. KPCC/D/A/211/2013, të 21 gushtit 2013 duhet të përmbahet nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);
- VI. TA URDHËROJË Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës të Gjykatës, ta njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VII. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDOS

Në rastin e parashtrueses së kërkesës Zorica Kršenković:

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të vlerësohet nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, dhe 54 të Kushtetutës, dhe të neneve 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- V. TË KONSTATOJË se Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore i Kosovës nr. KPCC/D/C/216/2013, i 22 nëntorit 2013, duhet të përmbahet nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);
- VI. TA URDHËROJË Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës të Gjykatës, ta njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

VENDOS

Në rastin e parashtruesit të kërkesës Zlatoj Jevtić:

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të vlerësohet nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, dhe 54 të Kushtetutës, dhe të neneve 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;
- V. TË KONSTATOJË se vendimi i Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. GSK-KPA-A-045/12, i 3 tetorit 2012, duhet të përmbrohet nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP);
- VI. TA URDHËROJË Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës të Gjykatës, ta njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi